



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

URDHËR

Nr. 1594 / Datë 07.03 2017

“PËR HEQJEN E LICENCES SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të shkronjës b) të nenit 6 të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994, “Për noterinë”, i ndryshuar.

KONSTATOJ

Referuar Regjistrin të Përgjithshëm të Noterëve, i cili administrohet nga Ministria e Drejtësisë, rezulton se notere Vasilika Kristo ka mbushur moshën 65 vjeç.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 6, gërma b), të ligjit nr. 7829, datë 1.06.1994, “Për Noterinë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

I. Heqjen e Licencës së Ushtrimit të Profesionit të Noterit znj. Vasilika Kristo, anëtare e Dhomës së Noterisë, Tiranë, për shkak të mbushjes së moshës 65 vjeç.

II. Ngritjen e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:

- a) Z. Arlind Arapi, Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.
- b) Z. Ermal Jahaj, Inspektor në Drejtorinë e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.
- c) Znj. Soeda Doçaj, Inspektore në Drejtorinë e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.
- d)
- e) Një përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë.
- f) Një përfaqësues i Dhomës së Noterisë Tiranë.

III. Arkivi do të merret në dorëzim me procesverbal në bashkëpunim me Dhomën e Noterisë, Tiranë. Arkivi do t'i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 45 ditor, noteres së Dhomës së Noterisë Tiranë, Stela Demneri.


IV. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noteres Vasilika Kristo, nga Komisioni i caktuar në pikën 2, të këtij urdhri.

VI. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet Sektori i Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe mund të ankimohet në gjykatë sipas ligjit.

MINISTRI

PETRIT VASILI



Miratoi: Juliana Hoxha Sekretar i Përgjithshëm
Bledar Kabashit, Drejtor i HIVPL
Punoi: Arlind Arapi Përgj. Sektori Drejtor i HIVPL
Datë: 6.03/2017